

ISSN 2521-831X

Nr.1

# **BULETINI MUJOR**

## **KLIMATIK**

**Janar 2017**

Universiteti Politeknik i Tiranës

Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit & Mjedisit

Tirana © 2017



# BULETINI MUJOR KLIMATIK

JANAR 2017

Nr. 1

**Buletini MuJOR Klimatik** i përgatitur nga Departamenti i Klimës dhe Mjedisit të IGJEUM, ka për qëllim të ofrojë një informacion shkencor mbi situatën meteorologjike të çdo muaji, menjëherë pas mbarimit të tij, si dhe në kontekstin klimatik, të japë vlerësimë mbi ndryshimet klimatike dhe tendencën e tyre në Shqipëri.

Buletini do të përbajë:

- Një vlerësim sinoptik dhe disa veçori kryesore nga pikëpamja meteorologjike që karakterizojnë muajin e analizuar.
- Të dhëna meteorologjike, të cilat pasi janë kontrolluar, digjitalizuar, verifikuar e përpunuar sipas standardeve tekniko shkencore të OBM, referuar një sërë vendmatjeve të Sistemit Kombëtar të Monitorimit Meteorologjik, kryesisht për temperaturën e ajrit, reshjet atmosferike, etj; do të pasqyrohen në formë grafikësh, hartash, tabelash, etj, më qëllim që të jepet një vlerësim i tyre për shpërndarjen në kohë e hapësirë për territorin e vendit tonë.
- Krahasimi me vlerat e normës referuar periudhës 1961-1990 apo periudhave të tjera kohore, do të mundësojë nxjerjen e përfundimeve me vlerë se si janë dhe se si po shkojnë ecuritë e elementeve të ndryshëm klimatikë, në këndvështrimin e ndryshimeve klimatike.
- Bazuar në produktet shkencore të vlerësimit të klimës prej qendrave më të njoitura profesionale shkencore në botë me të cilat institucioni ynë ka marrëdhënie bashkëpunimi, do të jepen vlerësimë për parashikim afatmesëm dhe afatgjatë të situatave të pritshme përmuajt në vazhdim, që pasojnë datën e emetimit të çdo buletini.
- Rubrikat e fundit të këtij buletini kanë të bëjnë me pasqyrimin e informacioneve të ndryshme që kanë lidhje me arritje shkencore në fushën e meteorologjisë apo klimës në veçanti, jo vetëm në vendin tonë; ngjarje të veçanta si "Dita Ndërkombëtare e Meteorologjisë", rezultate të punës kërkimore shkencore apo tematikave të ndryshme të realizuara nën udhëheqjen shkencore të departamentit.
- Tematika të caktuara shkencore me vlerë përvlerësimin e Klimës si pasuri kombëtare, si dhe në funksion të situatave të caktuara meteorologjike apo dukurive të evidentuara do të janë pjesë përbyllëse e këtij buletini, të gërshtuara me konsiderata mbi efektivitetin që do të kishte përdorimi i informacionit meteorologjik dhe klimatik për të patur një zhvillim të qëndrueshëm e progresiv të ekonomisë së vendit tonë, për të siguruar një mirëqenie më të mirë për popullin apo minimizuar pasojat nga dukuritë ekstreme të motit.

Bazuar në eksperiencën profesionale dhe në përvojën e gjatë në fushën e meteorologjisë dhe klimës mendojmë se ky buletin do ti vijë në ndihmë shumë përdoruesve të fushave të ndryshme të ekonomisë, studiuesve, vendimarrjes në nivele të ndryshme, studentëve e po ashtu medias dhe informimit të publikut në tërësi, për të ditur mbi bazë shkencore se çfarë po ndodh me klimën në Shqipëri dhe si pritet ajo në muajt apo vitet e ardhshme.


## Vlerësimi meteorologjik për muajin janar 2017

Muaji janar 2017 u karakterizua me mot mjaft të ftohtë, i cili nga data 5 deri më 13 në mënyrë të veçantë u shoqërua me ulje të fortë të temperaturave të ajrit dhe reshje të pakta dëbore. Situata sinoptike që paraprin këtë periudhë, më datë 4 janar paraqitet në figurën Nr.1. Kjo situatë ishte pasojë e mbizotërimit dhe përfshirjes së territorit të vendit tonë nën ndikimin e masave ajrore me origjinë siberiane, periferia e të cilave arriti përtëj skajit më jugor të Shqipërisë. Në datat 7, 8 dhe 9 janar u shënuan vlerat më të ulta të temperaturave të ajrit, të cilat thyen dhe rekordin kombëtar duke arritur në  $-29.0^{\circ}\text{C}$  në vendmatjen meteorologjike të Shtyllës, që ndodhet në lartësinë 1450 metra mbi nivelin e detit.

Gjithashtu duhet thënë se muaji janar 2017 pasojë një muaj pothuajse pa reshje, dhjetorin 2016, i cili ishte i ngjashëm dhe me dhjetorin 2015, që për më tepër ishte totalisht pa reshje në mbarë vendin dhe shënoi një rekord historik. Kësosoj edhe për këtë dimër evidentohet një karakteristikë e re nga pikëpamja klimatike në lidhje me reshjet. Gjithnjë e më shpesh në vitet e fundit po paraqitet një dimër me më pak reshje.

Kjo situatë e pasqyruar në vijimësi dhe në buletinet meteorologjike ditore (figurë Nr. 2) ka filluar të nxjerrë në pah treguesit e thatësirës meteorologjike dhe hidrologjike, pikërisht për muajt më me reshje të stinës së dimrit.

Figura Nr. 1. Situata sinoptike për datën 4 janar 2017.



Moti i acartë dhe temperaturat shumë të ulta, shoqëruar dhe me reshje dëbore, të cilat arritën deri në Konispol, krijuan një situatë problematike, që pati nevojë për ndërhyrje dhe marrjen e masave nga institucionet e emergjencave civile, për të siguruar jetën e njerëzve, si në zonat e themelore ashtu dhe në ato më të populluara pranë vijës bregdetare. Treguesi "wind-chill" shënoi vlera që evidentojnë një situatë të pa përshtatshme

për një jetesë dhe veprimtari normale humane në mjedis të hapur, në veçanti për periudhën 5 deri 13 janar 2017. Ndërkohë pas kësaj date filloj rikthimi në karakteristikat normale, që janë përfaqësuese për këtë periudhe kohore, ku fillimisht filloj procesi i shkrirjes së dëborës në zonën e ulët dhe atë kodrinore, siç jepet dhe në figurën Nr.3.




Figura Nr. 2. Buletini i parashikimit ditor të motit.





Figura Nr. 3. Vlerësimi i masës së shkrirjes së dëborës, i pritshëm për katër ditët në vijim, referuar datës 13 janar 2017.

Në vijim në figurat Nr. 4/1- 4/12 jepen të dhënat meteorologjike për temperaturat maksimale dhe minimale të ajrit si dhe reshjet e vrojtuarë për muajin janar 2017 për disa vendmatje meteorologjike, të përzgjedhura dhe përfaqësuese për zona të ndryshme.

Vlerësimi për ecurinë e temperaturës së ajrit dhe reshjet (figurat në vijim Nr. 4/1-4/12) në disa prej vendmatjeve meteorologjike të Sistemit Kombëtar të Monitorimit Meteorologjik për muajin Janar 2017.



## KARAKTERISTIKAT KRYESORE KLIMATIKE TË MUAJIT: JANAR 2017


Muaji janar nga pikëpamja klimatike për Shqipërinë është muaji kur vrojtohen temperaturat më të ulta gjatë gjithë vitit. Pikërisht për këtë në vijim, në tabelën Nr. 1 jepen disa të dhëna historike se kur janë vrojtuar temperaturat më të ulta absolute të ajrit në vendmatje të ndryshme meteorologjike në vendin tonë, ku rekordi deri më sot mbahej nga vlera **-25.8°C** në Sheqeras, të rrethit të Korçës.

*Tabela Nr.1 - Vlerat minimale absolute të temperaturës së ajrit për disa vendmatje meteorologjike.*


Vendmatja Meteorologjike	Temperatura minimalenë °C	Data e vrojtimit
Vermosh	-22.1	9 shkurt 1956
Kukës	-21.0	27 janar 1963
Peshkopi	-20.8	27 janar 1957
Sheqeras	<b>-25.8</b>	27 janar 1963
Dardhë	-21.8	14 janar 1968
Ersekë	-19.5	14 janar 1968
Bilisht	-24.8	20 janar 1967

Ndërkojë, muaji janar i këtij viti u karakterizua jo vetëm me ulje temperature, por dhe me reshje më të pakta në tërësinë e tyre si dhe me një raport të ri në lidhje me dëborën. Gjithashtu dhe lartësitë e dëborës së vrojtuar nuk shënuan rekorde, ndonëse kësaj here shtrirja e saj preku një pjesë të madhe të vendit dhe u vrojtua dhe në vendet e ekstremit më jugor të Shqipërisë, ku kjo dukuri meteorologjike është e rrallë.

Për këtë qëllim u përpunuau dhe analizuan të dhënat nga 52 vendmatje meteorologjike, prej të cilave u përzgjodhën disa prej tyre, si më përfaqësuese për zonat e ndryshme të vendit. Në figurat në vijim Nr. 5 deri Nr. 16 jepet një tablo e detajuar për elementë të ndryshëm meteorologjikë, që karakterizuarin muajin janar 2017; si p.sh: për temperaturën mesatare të ajrit, atë mesatare të vlerave minimeleve, maksimaleve e po ashtu për vlerat absolute, reshjet, numrin e ditëve me reshje mbi pragje të caktuar, lartësinë e dëborës, etj. Natyrisht evidentohet për këtë muaj vlera e rekordit të ri kombëtar të temperaturës minime absolute, të vrojtuar gjatë tre ditëve në vijimësi në vendmatjen e Shtyllës së rrethit të Korçës, më datat 7, 8 dhe 9 janar 2017, ku u regjistruan përkatesisht **-24.0°C**, **-28.4°C** dhe vlera rekord historik **-29.0°C**.



*Figura Nr. 5. Vlerat e temperaturës mesatare të ajrit për disa vendmatje meteorologjike të përzgjedhura për territorin e vendit tonë për muajin janar 2017.*



*Figura Nr. 6. Vlerat e temperaturës maksimale absolute të ajrit për disa vendmatje meteorologjike të përzgjedhura për territorin e vendit tonë për muajin janar 2017.*




Figura Nr. 7. Vlerat mesatare të temperaturës maksimale të ajrit për disa vendmatje meteorologjike të përzgjedhura për territorin e vendit tonë për muajin janar 2017.




Figura Nr. 8. Vlerat mesatare të temperaturës minimale të ajrit për disa vendmatje meteorologjike të përzgjedhura për territorin e vendit tonë për muajin janar 2017.

Një vëmendje e veçantë ju kushtua analizës së temperaturave minimale të ajrit, të cilat shënuan vlera mjaft të ulta, kryesisht në zonën lartë të vendit dhe në veçanti në pjesën JL të vendit.




Figura Nr. 9. Vlerat e temperaturës minimale absolute të ajrit për disa vendmatje meteorologjike të përzgjedhura për territorin e vendit tonë për muajin janar 2017.




Figura Nr. 10. Numri i ditëve me temperaturë minimale të ajrit nën  $0^{\circ}\text{C}$  për disa vendmatje meteorologjike të përzgjedhura për territorin e vendit tonë për muajin janar 2017.




Figura Nr. 11. Numri i ditëve me temperaturë maksimale të ajrit nën  $0^{\circ}\text{C}$  për disa vendmatje meteorologjike të përgjedhura për territorin e vendit tonë për muajin janar 2017.

Ndonëse ky muaj krijoj përshtypjen e një “dimri” të ashpër, në fakt përvëç uljes së ndjeshme të temperaturave të ajrit për rreth 10 ditë kundrejt vlerave normale të muajit, reshjet e vrojtuara ishin të pakta, nën normë dhe në formë dëbore, ku siç shihet dhe në figurën Nr. 15 edhe në zonat më të njoftura me këtë dukuri, të cilat në të shkuarën kanë patur lartësi të dëborës mbi 2 metra, kësaj here nuk arritën më shumë se 60-70 cm.




Figura Nr. 12. Lartësia e reshjeve (në mm) për disa vendmatje meteorologjike të përgjedhura për territorin e vendit tonë për muajin janar 2017.




Figura Nr. 13. Numri i ditëve me reshje mbi pragun 1.0 mm për disa vendmatje meteorologjike të përgjedhura për territorin e vendit tonë për muajin janar 2017.



Figura Nr. 14. Numri i ditëve me reshje mbi pragun 10.0 mm për disa vendmatje meteorologjike të përgjedhura për territorin e vendit tonë për muajin janar 2017.



Figura Nr. 15. Vlerat e reshjeve maksimale 24 orëshe për disa vendmatje meteorologjike të përzgjedhura për territorin e vendit tonë për muajin janar 2017.




Figura Nr. 16. Vlerat e lartësisë së dëborës (në cm) për disa vendmatje meteorologjike të përzgjedhura për territorin e vendit tonë për muajin janar 2017.

## Ndryshimet Klimatike

Krahasimi i të dhënave të vrojtimeve meteorologjike për muajin janar 2017 me të dhënrat e normës që i referohet periudhës 1961-1990, mundëson një vlerësim të rëndësishëm jo vetëm mbi ndryshimet e vrojtuara, por në veçanti me tendencat që po vrojtohen në vitet e fundit në karakteristikat kryesore të klimës. Muaji janar i këtij viti shënoi një rekord në historinë vrojtimeve meteorologjike për sa i takon uljeve të temperaturave minimale në shkallë vendi, ndërkoqë që, temperaturat mesatare të vrojtuara ishin rrëth -3°C më të ulta se norma, natyrisht me luhatje nga -1.5°C deri në -5.0°C paraqitur në figurën Nr.18; ndryshime që janë në funksion dhe të lidhura me kushtet orografike dhe tipet e mikroklimave lokale.

Figura Nr. 17. Situata e parashikuar pikërisht për datën 9 janar kur u vrojtuan vlerat ekstreme më të ulta të temperaturës së ajrit në Shqipëri.






Figura Nr. 18. Krahasimi i të dhënave të temperaturës mesatare të ajrit me vlerat e normës klimatike referuar periudhës 1961-1990.

Ndryshe nga një perceptim për dimrin e ashpër të krijuar për shkak të temperaturave të ulta dhe për një lagështi të lartë të tij, duhet thënë se reshjet ishin nën normë dhe ato arriën mesatarisht në shkallë vendi deri në masës 55% të vlerave të normës. Në figurën Nr. 19 jepet një pasqyrë më e detajuar për këto ndryshime. Për më shumë duhet theksuar se një pjesë e mirë e këtyre reshjeve ishte në formë dëbore duke krijuar një rrjedhje ujore sipërfaqësore të pakët. Në figurën Nr. 20 jepet një pamje nga reshjet e dëborës në Tiranë.





Figura Nr. 19. Krahasimi i të dhënave të reshjeve atmosferike te janarit 2017 me vlerat e normës klimatike referuar periudhës 1961-1990 tregon për një sasi rreth 45% më të ulët.

Një ndryshim i rëndësishëm në karakteristikat e klimës që vihet re dhe del në pah dhe përmirësohet janari 2017 është treguesi i numrit të ditëve me reshje mbi një prag të caktuar. Në vitet e fundit, por dhe janari i këtij viti u karakterizua me jo vetëm më pak reshje në sasinë totale të tyre, por dhe me një numër më të vogël të ditëve me reshje mbi pragun 1.0 mm, tregues i cili mesatarisht në shkallë vendi i përllogaritur për një sëri vendmatjesh meteorologjike përfaqësuese të të gjithë territorit ishte me rreth një të tretë më i pakët. Në figurën Nr. 21 jepet një pasqyrë e detajuar e numrit të ditëve me reshje mbi pragun 1.0 mm.

Figura Nr. 20. Pamje nga reshjet e dëborës në Tiranë më datë 11 janar 2017.






*Figura Nr. 21. Krahasimi i të dhënave të reshjeve atmosferike me vlerat e normës klimatike referuar periudhës 1961-1990.*

### VLERËSIME MBI SITUATËN METEOROLOGJIKE TË PRITSHME PËR MUAJT NË VIJIM.

Bazuar në produkte të përgatitura nga qendra të njoitura profesionale ndërkombëtare, në vijim jepen vlerësimë për ecurinë e pritshme të kushteve meteorologjike, të cilat në kontekstin klimatik do të ofrojnë një informacion me rëndësi për muajt në vijim, si në këndvështrimin kohor afat mesëm apo afatgjatë ashtu dhe sa i takon ndryshimeve klimatike.


**TEMPERATURA E AJRIT** - Për muajt shkurt, mars dhe prill 2017, pritet që sa i takon vlerave të parashikuara të probabiliteteve për temperaturat e ajrit për muajt:



vlerave të parashikuara të probabiliteteve për temperaturat mesatare të ajrit ato të kenë vlera më të larta se norma. Kjo siç shihet dhe në figurën Nr.21 pritet të jetë më e theksuar për pjesën qendrore dhe perëndimore të kontinentit european, ndërkohë që vendi ynë është në periferinë e ruajtjes së këtyre vlerave mbi normë.

*Figura Nr.22. Vlerat e parashikimit të probabiliteteve për temperaturat e ajrit për muajt shkurt, mars dhe prill 2017.*

**RESHJET ATMOSFERIKE** –Sa i takon reshjeve nga pikëpamja e probabiliteteve ato nuk paraqesin ndonjë përparësi për të qenë me mundësi mbi ose nën normë për reshjet e pritshme në muajt shkurt, mars dhe prill 2017 për të gjithë territorin e kontinentit european.




*Figura Nr. 23. Vlerat e parashikimit të probabiliteteve për reshjet për muajt shkurt, mars dhe prill 2017.*

## INFORMACIONE TË TJERA

Ndryshimet klimatike – konsiderohen tashmë një çështje e rëndësishme që duhet mbajtur në konsideratë në politikat kombëtare të zhvillimit në vende të ndryshme të botës. Natyrisht, krahas kësaj një rëndësi gjithnjë e më të madhe po merr dhe bashkëpunimi ndërkontrollor, pasi në përpjekjet për të ruajtur një klimë sa më të përshtatshme dhe mënjanuar pasojat negative është e nevojshme një kontribut i përbashkët i të gjitha vendeve.

Në vitet e fundit gjithnjë e më shumë klima po karakterizohet me disa karakteristika, të cilat në mënyrë të përbledhur janë: dimra më të shkurtër, por me një ashëpërsi të theksuar në disa raste, një “rrëshqitje” e stinëve, periudha më të gjata me thatësirë, theksim i dukurive ekstreme të motit, si reshje më intensive, reshje më të pakta në periudhën e ftohtë të viti, një rritje e netëve tropikale si dhe një prezencë më e shpeshtë e valëve të të nxehtit, ndryshim i raportit të reshjeve të shiut me ato të dëborës, ku kjo e fundit vrojtohet më pak, etj. Figura Nr.24 në vijim paraqet në mënyrë mjaft domethënëse se ç’po ndodh me klimën e re që po vrojtohet tashmë dhe atë që pritet të jetë prezente gjithnjë e më shpesh në vitet e ardhshme.



*Figura Nr. 24 – Paraqitje skematike e ecurisë së pritshme të probabiliteteve për temperaturën dhe reshjet për klimën e pritshme në të ardhmen, kundrejt klimës së mëparshme.*

Për të lexuar buletinet e tjera jeni të mirëpritur të viziton faqen përkatëse, duke klikuar në link-un e IGJEUM-it.



<http://www.geo.edu.al>



Ky "Buletin Mujor Klimatik" u përgatit nga  
Departamenti i Klimës dhe Mjedisit të  
IGJEUM-UPT.  
Tiranë © 2017.

